

**AKT I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR  
“SALIAJ AGENCY” sh.p.k.**

Në Tiranë, sot me datë 20.09.2022, në respektim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, unë, Megi Saliq, madhor, me zotësi jurdike dhe për të vepruar, identifikuar me anë të dokumentit të identifikimit me nr. personal J85309049U, me cilësinë e ortakut të vetëm, vendosa të themeloj dhe të hartoj Statutin e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “**SALIAJ AGENCY**” sh.p.k..

**KREU I**

Neni 1  
Krijimi

Shoqëria “**SALIAJ AGENCY**” sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**SALIAJ AGENCY**” sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i vetem”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga “Myslym Shyri”, nr. 7, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 4  
Objekti i veprimtarisë

Agjensi për veprimtari në fushën e organizmit të udhëtimeve turistike. Organizon transportin e mallrave dhe të udhëtarëve nga toka, ajri dhe deti.



Kryen shitjen e biletave të udhëtimit të linjave të ndryshme tokësore, ajrore, e detare. Ofson shërbime në rastin e udhëtimeve dhe pushimeve si: Rezervimi i vendeve të fjetjes në njësitë akomoduese turistike si hotele, vila etj., si dhe organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike-kulturore, etj. Ndërmjetësim me shitësit kryesore për produktet turistike.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**KREU II  
KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerisë është 3.000.000 lekë (të reja), i ndarë në një kuotë. Megi Saliaj, është zotëruese e 1 kuote me vlerë 3.000.000, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (*pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta*).

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 8  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



**KREU II**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9  
Organi Vendimmarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendsos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10  
Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Megi Salaj**.


Administratori i shoqërise do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5- vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë. Administrator i shoqërise mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11  
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;



- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 12  
Përgjegjësitë

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- 1 a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finansiar, Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rrëth shpërndarjes së dividentit, pasi të janë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finansiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mësiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërise.

Neni 17  
Prishja e shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.



Neni 18  
Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtronhet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19  
Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

Neni 20  
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthitura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.


Neni 21  
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare" i ndryshuar.

Neni 22  
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tij në shoqëri aksionare.



Neni 23  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “*Për tregtarët dhe shoqërite tregtare*”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24  
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe te tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Neni 25  
Dispozita përfundimtare

Ky Statut i shoqërise “**SALIAJ AGENCY**” sh.p.k., u redaktua nga unë, “*ortaku themelues*” në 2 ekzemplare me vlera të njëjtë juridike në gjuhen shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëta juridike.

*ORTAKU I VETËM  
“SALIAJ AGENCY” sh.p.k.  
Megi Salaj*

